



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 24.7.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
TË ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PËR VITIN E  
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, prill 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Laureta Matoshi-Pozhegu (Udhëheqëse ekipi) dhe nga Liridona Berisha-Kelmendi dhe Mimoza Morina (Anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Ramadan Gashi.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
5 Qeverisja e mirë.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	19
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme .....	22
Shtojca III: Letërkonfirmimi .....	28

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 07/02/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


#### Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e Kryetarit - auditimi 2017

Kryetari i Organi Shqyrtues të Prokurimit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e OSHP-së. Ne kemi analizuar veprimtarinë e OSHP-së se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP-së) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF-it, nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizata Buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

---

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Kryesuesi i Sekretariatit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i OSHP-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të OSHP-së.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve.**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

OSHP-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren e MF-it. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr.03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr.01/2013 dhe nr. 02/2013;
- Raportet tre mujore për obligimet e papaguara;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntë mujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2017; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

### **DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I OSHP-së**

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga menaxhmenti i OSHP-së me rastin e dorëzimit të PVF-ve në MF, është saktë dhe e drejtë, për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

OSHP ka kontrole të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Megjithatë, sfidë për institucionin edhe me tutje mbetet pagesat në mallra dhe shërbime si dhe menaxhimi i pasurisë.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	349,695	329,695	292,014	307,925	291,838
Granti i Qeverisë -Buxheti	349,695	329,695	292,014	307,925	291,838

Buxheti final<sup>1</sup> në raport me buxhetin fillestar<sup>2</sup> ishte më i ulët për 20,000€. Ky ndryshim është rezultat i reduktimit të grantit qeveritar për projektin Sistemi për Menaxhim të Ankesave (softueri) me vendim të Qeverisë nr.08/151 i datës 02.08.2017.

Në vitin 2017, OSHP ka shpenzuar 292,014€ apo 89% të buxhetit final, me një zvogëlim prej 10% krahasuar me vitin 2016. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm.

<sup>1</sup>Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

<sup>2</sup>Buxheti fillestar - Buxheti i planifikuar i paraqitur në Ligj të Buxhetit.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>349,695</b>	<b>329,695</b>	<b>292,014</b>	<b>307,925</b>	<b>291,838</b>
Pagat dhe Mëditjet	210,240	210,240	192,229	195,264	185,026
Mallrat dhe Shërbimet	114,355	114,355	96,409	108,638	105,469
Shërbimet komunale	5,100	5,100	3,376	4,023	1,343
Investimet Kapitale	20,000	-	-	-	-

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Për kategorinë e pagave dhe mëditje nuk kishte ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe atij final. Teprica e mjeteve financiare në fund të vitit (18,011€) ishte rezultat i suspendimit të dy zyrtarëve gjatë vitit 2017 si dhe masat disiplinore të ndërmarra për zyrtarët e tjerë, dhe kjo ka ndikuar në nivelin e përgjithshëm të realizimit të buxhetit në këtë kategori; dhe
- Realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte 84% e buxhetit final. Mjetet e pashpenzuar në fund vitit ishin 17,946€.

## 3.2 Të hyrat

Të hyrat e vitit 2017, kryesisht përbëhen nga depozitat e pranuar si rezultat i vendimeve për konfiskim, ndërsa në këtë vit nuk janë shqiptuar dhe paguar asnjë gjobë nga autoritetet kontraktuese. Përderisa depozitat<sup>2</sup> në fund të vitit (2017) ishin në vlerë prej 366,351€.

Burimi kryesor i të hyrave në OSHP janë nga ankesat për të cilat është vendosur në favor të autoriteteve kontraktuese dhe nga gjobat e shqiptuara.

**Tabela 3. Të hyrat e OSHP-së të transferuara në Buxhetin e Kosovës (në €)**

Përshkrimi	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat nga depozitat	37,231	116,895	78,500
Të hyrat nga gjobat	-	-	30,000
<b>Totali</b>	<b>37,231</b>	<b>116,895</b>	<b>108,500</b>

OSHP-ja realizon të hyra nga konfiskimet e depozitave të operatorëve ekonomik të cilave ju referohen ankesat si të pa pabazuara me vendime të paneleve shqyrtuese, të njëjtat pastaj kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës. Këto të hyra në 2017 ishin në vlerë prej 37,231€, krahasuar

<sup>2</sup> Depozitat janë të hyrat nga ankesat e operatoreve ekonomik, nëse ankesa e OE aprovohet atëherë bëhet kthimi i mjeteve.

me vitin e kaluar kemi një rënie në inkasimin për rreth 68% (2016 - 116,895€), kjo si rrjedhojë se disa prej ankesave janë parashtruar në muajin dhjetor, prandaj kohëzgjatja e vendimmarrjes i nënshtrohet dispozitave ligjore të LPP në fuqi.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### **3.3 Pagat dhe shtesat**

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësisive.

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 210,240€, ndërsa prej tyre ishin shpenzuar 196,427€ apo 93%, që është nivel i kënaqshëm i shpenzimit të buxhetit.

Numri i aprovuar i të punësuarve në OSHP ishte 23 (njëzetetre), ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 21 (njëzetënjë) punonjës. Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuar nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV. Bazuar në këtë konkludojmë se pagat dhe shtesat ishin menaxhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### **3.4 Menaxhimi i personelit**

Në testuam pajtueshmërinë e dosjeve të personelit, procedurat e rekrutimit, procesin e pensionimeve, pushimet e lehonisë, ndalesat dhe masat e ndërmarrura nga OSHP. Nga testimet e bëra është verifikuar se gjitha ndryshimet e ndodhura janë bërë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Për mostrat tona nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 119,455€. Prej tyre ishin shpenzuar 99,785€ ose 84%, krahasuar me vitin paraprak kemi një ulje të realizimit për 16%. Këto shpenzime lidhen kryesisht me shpenzimet e reprezentacionit, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, të trajnimeve dhe shpenzimet tjera administrative.

OSHP-ja kishte nënshkruar të 12 (dymbëdhjetë) kontratat e planifikuara për shërbime dhe furnizime për vitin 2017. Procedurat e prokurimit për OSHP-në kanë kaluar në përgjegjësinë e Agjencisë Qendrore të Prokurimit<sup>3</sup>.

Testet tona shpalosën çështjet si në vijim.

#### Çështja 1 – Furnizimi me kartela mbushëse të telefonisë mobile

- E gjetura** OSHP-ja për stafin e saj shfrytëzon kartelat mbushëse mujore nga Telekom i Kosovës SH.A “Vala” që e faturon çdo muaj. Ne kemi vërejtur se për këtë shërbim nuk kishte marrëveshje apo kontratë të nënshkruar me Telekomin e Kosovës SH.A, ku përcaktohet çmimi i minutave/sms-ve të shpenzuar, sasia, shumat e pagesës për muaj dhe koha e caktuar për pagesë. Gjatë viti 2017, gjithsej mjetet financiare të shpenzuar për këtë shërbim ishin në vlerë 6,555€.
- Rreziku** Furnizimi me kartela mbushëse të telefonisë mobile pa marrëveshje/kontratë mund të shpien në marrjen e shërbimeve si sasi ashtu edhe cilësi të nivelit të dobët nga dhënësi i shërbimit.
- Rekomandimi 1** Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj që janë vendosur kontrollet e duhura në këto pagesa, dhe para se të bëhet shpenzimi së pari të nënshkruhet një marrëveshje/kontratë ku specifikohet lloji i shërbimit, çmimi i shërbimit, sasia, koha e furnizimit dhe e pagesave. Po ashtu, OSHP si mundësi tjetër mund të shfrytëzoj kontratën e MAP-it për shfrytëzimin e shërbimeve të telefonisë mobile të nënshkruar me Telekomin e Kosovës “Vala”.

<sup>3</sup> LPP Nr. 04/L-04, neni 21a, ku përcakton se për qëllime të ekonomizimit të aktiviteteve të prokurimit për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës, procedurat e prokurimit i kryen AQP-ja.

---

## Çështja 2 – Pagesë për biletë të pashfrytëzuar të aeroplanit

- E gjetura** Gjatë auditimit kemi vërejtur në një rast ishte paguar bileta në vlerë prej 394€ për një zyrtare e cila ishte planifikuar për udhëtim zyrtar në Slloveni, mirëpo në momentin e fundit, udhëtimi ishte anuluar për këtë zyrtare. Kjo ka ndodhur për shkaqe subjektive, pa ndonjë arsyeje serioze nga grupi pjesëmarrës i udhëtimit zyrtar (përveç një njoftimi me telefon për zyrtaren që të mos merr pjesë në këtë udhëtim, përkundër konfirmimit të pjesëmarrjes në agjendë dhe rezervimit të biletës), për më tepër vlen të theksohet se takimi i planifikuar ishte mbajtur dhe njëri anëtarë i grupit ishte pjesëmarrës në Slloveni.
- Rreziku** Mos anulimi me kohë i udhëtimit zyrtar dhe ekzekutimi i pagesës pa e shfrytëzuar shërbimin, rrit rrezikun se kjo formë e pagesës mund të konsiderohet e parregullt dhe mund t'i shkaktojë dëm financiare OSHP-së.
- Rekomandimi 2** Kryetari i OSHP-së duhet të siguroj kontrolle të duhura në këto shpenzime, në situata të tilla, anulimet eventuale të bëhen në kohën e duhur në mënyrë që zyrtarët e OSHP-së të koordinohen me OE për të i anuluar biletat e rezervuar me qëllim që t'i shmangin shpenzimet e tilla pa e shfrytëzuar shërbimin. Shpenzimet të ekzekutohen në pajtim me rregullat financiare.

## 3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PVF ishte në vlerë 2,966€, pasuritë nën 1,000€ ishin në vlerën 29,129€ ndërsa stoqet 3,156€. Më tutje, 87% të pasurive kapitale të regjistruara në regjistrin kontabël në SIMFK dhe 13% të pasurive jo kapitale të regjistruara në regjistrin e-pasuria ishin me vlerë zero.

Ne testuam blerjet e vitit 2017, rregullsinë në regjistrimin e pasurisë, si edhe ekzaminimin fizik për të verifikuar ekzistencën e pasurive.

Auditimi ynë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi dobësitë e paraqitura më poshtë.

### Çështja 3 - Mangësi në menaxhimin e pasurive

**E gjetura** OSHP kishte formuar komisionet për vlerësim<sup>4</sup> dhe inventarizimin<sup>5</sup> të pasurive, të cilat kishin evidentuar disa pasuri që ishin jashtë përdorimit dhe figurojnë në regjistër të pasurive duke i rekomanduar menaxhmentit që të largohen nga regjistri i e-pasurisë. Në dy (2) nga nëntë (9) mostrat e testuara, kemi vërejtur se përkundër rekomandimit të komisioni të vlerësimit këto pasuri nuk ishin larguar nga regjistri i pasurive, siç kërkohet me nenin 9 të rregullores 02/2013.

Sistemi i e-pasurisë nuk e kishte kalkuluar zhvlerësimin e disa pajisjeve të IT-së si dhe disa pajisjeve tjera, dhe për këtë OSHP nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për të rregulluar këtë problem. Sipas pohimit të zyrtarit të pasurisë zhvlerësimi duhet të kryhet nga MAP në mënyrë automatike, mirëpo kjo nuk është aplikuar drejtë. Për më tepër këtë çështje e kemi trajtuar duke dhënë rekomandime edhe në vitin e kaluar.

**Rreziku** Mbajtja në regjistrin e pasurisë disa pasuri të cilat janë jashtë përdorimit si dhe mos zhvlerësimi i të gjitha pasurive, rezulton me atë se sistemi i e-pasurisë mund të gjenerojë informata jo të sakta dhe të rrit rrezikun që pasuritë të mbivlerësohen dhe prezantimi i tyre në PFV të mos jetë i saktë.

**Rekomandimi 3** Kryetari i OSHP-së duhet të sigurojë që menaxhimi i regjistrave bëhet në përputhje me rregulloren për menaxhimin e pasurive, përkatësisht të sigurojë largimin e pasurive jashtë përdorimit sipas vlerësimeve të komisionit përkatës, si dhe të sigurohet se në sistemin e e-pasurisë aplikohen normat e përcaktuara të zhvlerësimit.

## 3.7 Të arkëtueshmet

Regjistri i llogarive të arkëtueshmeve të OSHP-së, sipas të dhënave të shpalosura në PFV në vitin 2017 ishin 216,000€, vlerë e njëjtë me vitin paraprak.

OSHP-ja gjatë vitit 2017 nuk ka arritur të arkëtoj asnjë të hyrë nga llogarit e arkëtueshme, si rezultat i ankesave të parashtruara në gjykatë nga palët ndaj vendimeve të OSHP-së dhe vonesave në shqyrtimin e tyre.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

<sup>4</sup> Vendimi nr. 977/17 të datës 06/11/2017.

<sup>5</sup> Vendimi nr. 843/17 të datës 02/10/2017.

### 3.8 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 7,946€. Në përgjithësi OSHP ka kontrolle të mira në menaxhimin e obligimeve. Vlera e mbetur si obligim ishte për shkak se, pjesa më e madhe e faturat të pranuar kishin arritur në muajin dhjetor, e që ndërliken me shpenzimet për pagesat e ekspertëve të jashtëm. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018.

#### Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV të vitit 2016, ka rezultuar me 12 (dymbëdhjetë) rekomandime. OSHP kishte përgatitur një Plan Veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për PFV për vitin 2016 të ZKA, ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, katër (4) janë në proces ndërsa tre (3) nuk janë adresuar ende.

Për më tepër, nga viti 2015 ishin bartur edhe katër (4) rekomandime, një (1) i pa zbatuar dhe tre (3) të tjera ishin në zbatim e sipër. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

### Çështja 4 - Zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake

<b>E gjetura</b>	Niveli aktual i trajtimit të rekomandimeve nuk është i kënaqshëm për shkak se OSHP nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të rishikuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve dhe identifikimin e pengesave për veprim në adresimin e tyre të plotë. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësim të vazhdueshëm në të gjithë organizatën.
<b>Rreziku</b>	Mungesa e një monitorimi efektiv të zbatimit të rekomandimeve ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme lidhur me qeverisjen e mirë, mallra dhe shërbime si dhe në menaxhimin e pasurive.
<b>Rekomandimi 4</b>	Kryetari i OSHP-së duhet të sigurojë që plani i veprimit rishikohet dhe rifreskohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe mekanizma llogaridhënës ndaj të gjithë personave përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.



## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë përfshinë parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërme të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në raport me vitin e kaluar, menaxhmenti i OSHP-së ka bërë përmirësime në aranzhimet e qeverisjes së mirë dhe se raportimi ishte në nivel të duhur. Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar ka nxjerrë në pah një raportim të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat.

Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të OSHP-së. Kërkohet një seriozitet në plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit, pasi që edhe pse është plotësuar kërkohet përpikëshmëri në informatat e prezantuara. Pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit paraprak nuk ishte zbatuar, tek menaxhimi i rrezikut OSHP-ja ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara për identifikimin e rreziqeve, mirëpo nuk raportohet mbi monitorimin e tyre.

#### 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur.

Në bazë të UA Nr.23/2009 për Themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, OSHP-ja nuk i plotëson kriteret<sup>6</sup> për themelimin e NjAB-së.

Në mungesë të NjAB-së, auditimi i brendshëm kryhet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm në kuadër të MF-it, që si rrjedhojë ishte kryer nga një auditim i brendshëm në OSHP. Mirëpo gjatë

<sup>6</sup> Mbi 1 milion buxhet, 50 staf të punësuar, si dhe shkallë lartë të rrezikshmërisë

vitit 2017 nuk ishte zhvilluar ndonjë proces i auditimit të brendshëm nga DAB për OSHP-në edhe përkundër kërkesës së bërë në MF. Ne inkurajojmë menaxhmentin që të bëjë një rishikim të nevojave për auditim të brendshëm dhe të konsiderojë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me ndonjë organizatë tjetër të sektorit publik që të shfrytëzojë shërbimet e auditimit të brendshëm.

### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## **5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut**

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur të menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Nga rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në këtë fushë, mund të konkludojmë se menaxhmenti ka vendosur një strukturë organizative adekuate, kishte bërë delegimin e detyrave dhe përgjegjësive dhe ishte informuar për proceset e zhvilluara në kuadër të OSHP-së. Departamentet dhe divizionet përgatisin raporte mujore të rregullta pune dhe dërgohen tek Drejtori i Sekretariatit.

### **Çështja 5 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut**

**E gjetura** Kemi identifikuar kontrolle jo efektive në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe në menaxhimin e pasurisë.

OSHP ka të hartuar strategjinë dhe regjistrin e përgjithshëm të rreziqeve sipas kërkesave të MFK-së, në të cilin i ka identifikuar sfidat dhe vështirësitë që përballet gjatë aktiviteteve të përditshme. Edhe pse OSHP çdo tre muaj ka dokument të shkruar për rreziqet e parapara, nuk ka ndonjë azhurnim apo raport konkret të monitorimit mbi këto rreziqe.

**Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut dhe të kontrolleve do të ndikojë në mos adresimin me kohë të mangësive duke reduktuar kështu efektivitetin dhe ndikon në mos përmbushjen e objektivave dhe planeve të synuara.

**Rekomandimi 5** Kryetari i OSHP-së duhet t'i shqyrtojë shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushat e cekura më lartë dhe të sigurojë azhurnim dhe monitorim të vazhdueshëm të listës së rreziqeve.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Qeverisja e mirë	Kryetari i OSHP-së duhet t'i japë prioritet implementimit të të gjitha rekomandimeve të auditimit dhe të sigurohet që plani i veprimit menaxhohet në mënyrë proaktive i cili duhet të përmbajë hollësi lidhur me stafin llogaridhënës dhe afat kohor për implementimin e secilit rekomandim. Implementimi i planit të veprimit duhet të rishikohet në baza mujore.		Vitin 2017, ky rekomandim është adresuar pjesërisht.	
Qeverisja e mirë	Kryetari duhet të sigurojë se lista e vetë-vlerësimit shfrytëzohet në mënyrë proaktive për të nxitur përmirësimin organizativ si dhe të ketë një proces të rishikimit nga Kryetari në baza tremujore.		Pjesërisht e adresuar. Pyetëtori plotësohet por ende nuk kemi raport të monitorimit.	
Qeverisja e mirë	Kryetari duhet të sigurojë se kërkesat për menaxhimin e rrezikut të rivlerësohen brenda 3 muajve të ardhshëm duke adresuar nevojën për azhurnim të regjistrit të rreziqeve si dokument të "gjallë" dhe të identifikojë zyrtarët përgjegjës. Veprimet e ndërmarra për të zvogëluar ndikimin e rreziqeve të identifikuara duhet të rishikohen nga Kryetari çdo tremujor.	Rekomandim i adresuar në vitin 2017.		
Qeverisja e mirë	Kryetari duhet të sigurojë një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është bërë një zgjidhje e përshtatshme sa shpejtë që të jetë e mundur.	Rekomandim i adresuar në vitin 2017		

3. Planifikimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë përmirësim të monitorimit sistematik të performancës buxhetore, i cili i shqyrton dobësitë në kontrole në nivel të kodeve ekonomike, reflekton vlerësime realiste të rrjedhës së parasë dhe identifikon zërat e panevojshëm për buxhet.			Rekomandim i pa adresuar edhe në vitin 2017.
3.4 Prokurimi	Kryetari i OShP të sigurojë se pagesa e faturave të pranuar të bëhet në afatin e përcaktuar ligjor.		Rekomandim pjesërisht i adresuar, pasi që edhe në vitin 2017 kemi hasur në vonesa të pagesave.	
3.4 Prokurimi	Kryetari të sigurojë se të gjitha kontratat kornizë përmbajnë sasi të përafërta të mallrave që pritet të blihen gjatë kohëzgjatjes së kontratës.	Në vitin 2017 të gjitha proceset e prokurimit për OSHP-në kryhen nga AQP.		
Të hyrat	Regjistrimet ekzistuese në SIMFK nuk e identifikojnë deponuesin (dokumentin burimor) dhe transaksionet e llojit të njëjtë përshkruhen në tri mënyra: depozita, të hyra, raport i datës përkatëse të regjistrimit.  Korrigjimet në SIMFK në vitin 2015, në shumë prej 169,000€, nuk iu kishin nënshtruar një procesi të miratimit dhe nuk kishin përshkrim të qartë se pse kishin ndodhur.	Rekomandim i adresuar.  Nuk kemi hasur në korrigjime dhe ndonjë përshkrimi të paqartë në vitin 2017.		

Pasuritë kapitale dhe jokapitale	<p>Komisioni për inventarizim kishte konfirmuar se pasuria në regjistra përputhet me pasurinë fizike dhe se nuk kishte gjetur ndonjë parregullsi. Megjithatë asgjë nuk kishte thënë lidhur me vlerën e pasurisë nën 1,000 euro.</p> <p>Në sistemin e-pasuria, përkatësiht në PVF, vlera e mbetur e pasurisë së OShP ishte mbivlerësuar për 4,000€, për të cilën gjë as zyrtari i pasurisë as menaxhmenti nuk ishin në dijeni. Zyrtari i pasurisë nuk ka qasje për të bërë ndryshime në sistem.</p>	<p>Rekomandim i adresuar në vitin 2017.</p> <p>Rekomandim i adresuar ne vitin 2017.</p>		
Llogaritë e arkëtueshme	Borxhet nga gjobat e shqiptuara ndaj Autoriteteve Kontraktuese kishin pasur rritje prej 30,000€ në krahasim me vitin paraprak. Arkëtimi ishte i dobët pjesërisht për shkak të ankesave të parashtruara në gjykatë.	Në vitin 2017, asnjë gjobë nuk ishte shqiptuar dhe asnjë nga borgjet paraprake nuk ishte paguar.		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Qeverisja e mirë	Kryetari i OShP-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.			Ky rekomandim nuk është plotësuar ende, edhe këtë vit kemi vërejtur se nuk ka raport te monitorimit mbi rekomandimet e dhëna dhe fushat e rëndësishme.



Qeverisja e mirë	Kryetari i OShP-së duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Ky rekomandim është në proces pasi që edhe pse plotësohet pyetësori i vetëvlerësimit kërkohet përpikshmëri në informatat e prezantuara.	
Qeverisja e mirë	Kryetari i OShP-së duhet t'i shqyrtojë shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushat e cekura më lartë dhe të sigurojë eliminimin e dobësive të identifikuar.		Ky rekomandim është implementuar pjesërisht, ku kemi përmirësim në linjat e raportimit mirëpo ende kontrollet mbi procedimin e pagesave mungojnë.	
Planifikimi i buxhetit	Kryetari i OShP-së duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Ky rekomandim është adresuar.		

Te hyrat	Kryetari i OShP-së duhet të sigurojë se të hyrat janë duke u menaxhuar sipas kërkesave ligjore dhe gabimet identifikohen me kohë. Kjo do të ndihmonte nxjerrjen e shënimeve të plota dhe të sakta në PFV.	Kjo pikë e rekomandimit është adresuar. Vërehen përmirësime dhe se këtë vit mund të themi se OSHP ka vendosur kontrolle funksionale në të hyrave.		
Mallra dhe shërbime	Kryetari i OShP-së duhet të rishikojë arsyet e vazhdimësisë së mangësive në procedimin e pagesave dhe të sigurojë zbatimin e kontrolleve efektive në këtë fushë.			Ky rekomandim ende nuk është adresuar në masë të plotë, kemi vërejtur përmirësime por ende në disa pagesa nuk është adresuar në masë të plotë.
	Kryetari i OShP-së në bashkëpunim me personat përgjegjës duhet të siguroj mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.		Pjesërisht e adresuar. Nga auditimi jonë kemi verifikuar se ende ka vonesa edhe pse ka përmirësime këtë vit.	
	Kryetari i OShP-së të sigurojë kontrolle shtese në menaxhimin e pagesave. Tatimi në burim duhet të ndalet dhe të deklarohet në ATK për të gjitha situatat e parapara me legjislacionin në fuqi.	Rekomandim i adresuar plotësisht. Nga auditimi jonë kemi verifikuar se është ndalur tatimi në burim.		

Menaxhimi i pasurisë	Kryetari i OShP-së duhet të sigurojë se i ka forcuar kontrollet në menaxhimin e pasurisë. Në fund të çdo viti pas procesit të inventarizimit, duhet të harmonizohen regjistri i përgjithshëm i pasurisë me regjistrin e nxjerrë në procesin e inventarizimit. Nëse konstatohen diferenca atëherë duhet të jepen sqarime për ndryshimet e paraqitura.		Rekomandim pjesërisht i adresuar. Në këtë vit kemi hasur në mos harmonizim të regjistrave.	
Menaxhimi i pasurisë	Kryetari i OShP-së duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerren veprimet e duhura që e gjithë pasuria t'i nënshtrohen zhvlerësimit duke aplikuar normat përkatëse të zhvlerësimit.			Rekomandim i pa adresuar edhe në vitin 2017.
Menaxhimi i pasurisë	Kryetari i OShP-së duhet të sigurojë kontrolle shtese në menaxhimin e depos. Duhet të mbahen evidenca të plota lidhur me regjistrimin dhe transferimin e stoqeve në mënyrë që të shmangen gabimet gjatë planifikimit të blerjeve.	Rekomandim i adresuar. Kemi verifikuar se këtë vit janë mbajtur evidenca mbi stoqet.		
Menaxhimi i pasurisë	Kryetari i OShP-së të sigurojë kontrolle shtese në Njësinë e transportit, në mënyrë që menaxhimi i automjeteve të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore. Drejtuesit e automjeteve duhet të dorëzojnë raporte të rregullta lidhur me shpenzimet rreth përdorimit të automjeteve.	Rekomandim i adresuar. Janë aplikuar përmirësimet sa i përket raportimit mbi shpenzimet rreth përdorimit të automjeteve.		

## Shtojca III: Letërkonfirmimi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
 Nr/Br. 395118  
 Data/Datum 19.04.2018  
 PRISHTINË - PRISTINA

---

**LETËR E KONFIRMIMIT**

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit Financiar të Organi Shqyrtues të Prokurimit për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Prishtinë

Dt: 19.04.2018

Kryetari i OSHP-së:  
 Blerta DINA

